

Adresimi i diskriminimit të shumëfishtë përmes litigimit strategjik

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) organizoi Tryezën e Rrumbullakët me temë: “Mbrojtja nga diskriminimi i shumëfishtë. Roli i organizatave të shoqërisë civile në identifikimin dhe parandalimin e tij.”

Aktiviteti u organizua në kuadrin e projektit “Adresimi i diskriminimit të shumëfishtë përmes litigimit strategjik”, zbatuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, me mbështetjen e Civil Rights Defenders, CRD.

Zj. Irma Baraku, Komisionere për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe përfaqësues të tjerë nga institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësues nga institucioni i Avokatit të Popullit, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse si Lëvizja Rinore Rome dhe Egjiptiane, Qendra për Zhvillimin e Grave Rurale, shoqata “Unë Gruaja”, Pogradec, qendra “Sot për të ardhmen”, projekti ESERE UNDP, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra për të Drejtat e Gruas Rome, qendra “Të ndryshëm dhe të Barabartë”, CRCA, Ambasada PINK, AËEN, TLAS, Shoqata e Grave me problem sociale, Shkolla Kombëtare e Avokatisë, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Tiranë, Fondacioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Forumi i Gruas Elbasan, etj., morën pjesë në këtë aktivitet. Në aktivitet mori pjesë edhe Zj. Vasilika Laçi, Oficere Programi, pranë Civil Rights Defenders.

Çështje si: kuptimi i diskriminimit të shumëfishtë dhe mekanizmat ligjorë për mbrojtjen ndaj tij, nevoja për përmirësime në kuadrin ligjor ekzistues antidiskriminim, arritje dhe sfida në adresimin e diskriminimit të shumëfishtë, referuar në praktikën e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare si dhe vështrime krahasuese me legjislacionin dhe praktikën gjyqësore në vende të tjera ngjallën interesin e pjesëmarrësve.

Aktiviteti u përmbyll me disa konkluzione të rëndësishme si nevoja për përmirësime në ligjin nr.10221, datë 4.2.2010, ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’, forcimin e bashkëpunimit mes organizatave jofitimprurëse si dhe midis organizatave dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bashkëpunimin e organizatave jofitimprurëse me Fakultetin e Drejtësisë,

Universiteti i Tiranës, nevoja për forcimin e kapaciteteve të organizatave jofitimprurëse në lidhje me adresimin e diskriminimit të shumëfishtë, etj.



Foto nga Tryeza e Rrumbullakët me temë: “Mbrojtja nga diskriminimi i shumëfishtë. Roli i organizatave të shoqërisë civile në identifikimin dhe parandalimin e tij”, Tiranë më datë 08.11.2016.